



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.06.2022, merr këtë

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E INSTITUCIONIT
PARASHKOLLORË NË LAGJEN "MATI 1" NË PRISHTINË

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollorë në lagjen "MATI 1" në Prishtinë.
- II. Lokacioni nga pika I e këtij vendimi gjendet në kuadër të Planit Rregullues Mati 1 i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës nr. 01. Nr. 35-642 dt. 01.04.2010 parcelat kadastrale me nr. 546-0, 547-0, 548-0, 549-0 Zk Matiçan (kanë sipërfaqe kadastrale prej 1.28Ha, ndërsa sipërfaqja/zona e planifikuar për ndërtim të IP është rreth 0.30Ha, pjesa tjetër e sipërfaqeve kadastrale do të mbetet sipas përmbajtjeve me Planin Rregullues Mati 1). Pronësia e parcelës nr. 875-1 Zk Prishtinë është pronë shoqërore K.K Prishtinë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij vendimi dhe ekstrakti nga Plani Rregullues MATI 1.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Kadastrit. Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Pronës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-151676/22, më 30.06.2022

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupa



ARSYETIM

Në bazë të takimeve të zhvilluara ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, por edhe duke u bazuar në kërkesat dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike është arritur akordimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit Parashkollorë në kuadër të lagjes Matičan në Prishtinë.

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartë cekur ka identifikuar lokacionin për ndërtimin e I.P i cili gjendet në kuadër të Planit Rregullues Mati 1 i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës nr. 01. Nr. 35-642 dt. 01.04.2010 (*parcela e propozuar për ndërtimin e Institucionit Parashkollor sipas Planit Rregullues Mati 1, shtrihet në zonë të destinuar për qendër të kujdesit shëndetësor, infrastrukturë rrugore e planifikuar, një pjesë për ndërtim të lartë dhe një pjesë për gjelbërim*), parcelat kadastrale me nr. 546-0, 547-0, 548-0, 549-0 Zk Matičan (*kanë sipërfaqe kadastrale prej 1.28Ha, ndërsa sipërfaqja/zona e planifikuar për ndërtim të IP është rreth 0.30Ha, pjesa tjetër e sipërfaqeve kadastrale do të mbetet sipas përmbajtjeve me Planin Rregullues Mati 1*) pronësia e parcelës nr. 546-0, 547-0, 548-0, 549-0 Zk Matičan është pronë shoqërore K.K Prishtinë.

Bazuar në gjendjen faktike konstatohet se lokacioni në fjalë është sipërfaqe e zbrazët, ndërsa tereni ka pjerrtësi të lehtë në drejtim të Jug-Perëndimit.


Harmonizimi i planeve ndërmjet veti do të bëhet gjatë procesit të hartimit të planeve hapësinore siç është Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues Mati 1 (*parcela e planifikuar për ndërtim të IP*).

Bashkangjitur:

- skica e lokacionit të propozuar,
- ekstrakti nga plani rregullues Mati 1,



Lokacioni i propozuar;



- Pjesa grafike nga Plani rregullues Mati 1 01. Nr. 35-642 dt. 01.04.2010;